



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.70/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, me seli në Komuna e Drenasit, parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komunën e Drenasit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHEȚ e pabazuar ankesa e subjektit politik, Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, me seli në Komuna e Drenasit, ZL.Anr.70/2025, e datës 26.09.2025, e paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna e Drenasit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 26.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, në të cilën theksohet se në intervistën e dhënë mbrëmë me datë 25.09.2025, në emisionin "DPT Te Fidani", të transmetuar në Klan Kosova, z. Petrit Hajdari ka hedhur një seri shpifjes, fyterjesh dhe konspiracionesh me qëllim të dëmtimit dhe përmajtjes së personalitetit kundër kandidatit të tij z. Ramiz Lladrovci, nga subjekti politik "Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci" përfitime elektorale duke vepruar në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes dhe Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Duke theksuar se, kur të analizohet konteksti politik, social e rajonal, duke e ditur se deri më tani, Drenasi ka qenë bastion i PDK-së, pretendimet e tillë kanë peshë për qytetarët e Drenasit, veçanërisht ndërlidhjet e z. Lladrovci me Lëvizjen Vetëvendosje, shantazhin dhe gjoja veprimet në kundërshtim me "amanetin" e Hashim Thaqit e Kadri Veselit. Parashtruesi ka cituar në ankesë disa nga deklaratat si: "*Albin Kurti e ka gjete një instrument, një listë me*

emra personal, normal që qytetarët e Drenasit janë me të mençur se kaq; Tendencë e Albin Kurtit me përça PDK-në (...) iniciativë me emra personal, dhe besoj që qytetarët e kanë kuptu që komplet është bërë instrument i VV-së; Marrëveshjet e fshehta nëpër tavolina me Albin Kurtin, për me dëmtua dhe me përça Drenicën... krejt anëtarësia e VV e përkrah e suporton z. Lladrovci, dhe ai po tenton me përça Drenasin, po qytetarët e Drenasit janë më të mençur se kaq [...] Je kemi amanet nga liderët tanë prej liderëve tonë Hashim Thaqi, Jakup Krasniqit e Kadri Veselit, pavarësisht tendencës së Albin Kurtit, atina i konvenon; Tash e ka gjete marionetën atje në Drenas, ka themelu një iniciative me emër krejt personal, vota për të është votë direkt për Albin Kurtin; Çka dallon ti prej kundër kandidatit t'ju j?; Pika e parë unë nuk i rrej qytetarët, unë nuk i mashtroj ata, unë nuk e tradhetoj besimin e qytetarëve dhe unë kam logjikë bashkëpunuese; Në kohën kur PDK po rritet në secilën komunë, dikush atje po do me dëmtu, kjo është strategji e mirë planifikume;" Pra siç u tha më sipër, kjo ndërlidhje, përvèç të tjerash nxit urrejtje e cila mund të qojë drejt konfrontimit fizik të simpatizantëve nga të dyja anët.

Për të thelluar këtë ndarje përmes nxitjes së urrejtjes duke e cilësuar si përçarës e pjesëmarrës në një komplot ndaj PDK-së, z. Hajdari merr rolin e timonierit duke u thirre në "amanetin" e Hashim Thaqit e Kadri Veselit. *"E kam detyrë dhe amanet me i shty projektet e mëdha për vendin; Ky zotnia u ka turist në PDK kur është zgjedhur Hashim Thaqi kryeministër ky u ka sekretar organizativ në AAK dhe në njëfarë forme e ka thyen edhe krahun e luftës; Pasi i ka fituar zgjedhjet i ka thyen kambë e duar me ba një fotografi me Sami Lushtakun."*

Me tutje ka theksuar se, z. Hajdari, vazhdon me shpifje duke tentuar ta ndërlidhë z, Lladrovci si pjesë e një grupei që punon për interesa të grupeve të caktuar, si kërcënues e shantazhues, përderisa qytetarëve ua "mbyll derën" pa treguar gjoja interesim për hallet e tyre dhe si kontribuuves në shpërnguljen e tyre drejt qyteteve tjera, kur nga statistikat e ASK dihet se Komuna e Drenasit ka thuajse me pak se mesatarja e Komunave tjera përreth dhe në nivel Kosove.

"Na nuk punojmë për kompani dhe interesa klienteliste; Nuk e mylli derën ndaj qytetarëve, jam i qasshëm kërkosat kanë mbetur në tavolina dhe askush nuk është marrë me to; Një pjesë e madhe e njerëzve që i kam takuar gjatë këtyre ditëve kanë ikë nga Drenasi për shkak se askush nuk i afro kuadrot që sot janë në Prishtinë se nuk ju është ofruar zgjidhje; Pjesa e madhe e fshatrave për shkak të ujit të pijes janë ikë nga fshatrat; Për gjashtë vjet nuk ju ka dhanë qytetarëve leje ndërtimi dhe njerëzit janë detyruar të blejnë ndërtesa në Fushë Kosovë; Drenasin do ta bëjmë të jetueshëm; Bizneset po ikin nga Drenasi për taksën e biznesit se Fushë Kosova s 'ka taksë të biznesit; Zotnia e ka gjete një ekip futbolli kampion e sot është në ligën e dytë, me buxhet ma të madh se klubi Ballkani; Unë e bëj politikën pa borxhe; Drejtorat që i kanë ardhë me duar në xhepa sot janë milionera, vetëm një a dy drejtorë janë të PDK-së; Ai nuk është msu me u marrë me hallet e qytetarëve, ai u msu tuj nej nëpër helikopter tuj u shëtit nëpër Barcelonë, jemi msue tuj e pa nëpër tribuna VIP në secilën ndeshje sportive, qytetari i varfër e ka një kryetar milioner; Me 12 tetor do të hiqet kërcënimi dhe shantazhi, si njerëzve në arsim, njerëzve në shëndetësi, kërcënimi për mospjesëmarrje në tubime të PDK-së, shembull ma i freskët, dje, dy zyrtare të lavendarisë në shtëpinë e shëndettit pardje drejtori i ka largua prej pune; Bizneset nuk duhet trajtuar si armiq, jo fokusimi të dy tri biznese të mëdhaja që

punojnë për njerëz të caktun, por me pasë që do biznes bashkëpunëtorë nuk do të ketë privilegje dhe monopol...jo absolut; në mënyrë që I 'ia kthejmë dinjitetin qytetarëve të Drenasit." Parashtruesi ankesës i ka bashkangjitur si provë: Video incizimin e bashkangjitur në CD, dhe linku: <https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=tFNvQEWA&feature=youtu.be>,

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, të datës 26.09.2025 theksohet se në ankesë janë cituar pjesë nga intervista e gjatë e z. Hajdari, me të cilat ankuesi pretendon se me deklarimet e tij në këtë emision, z. Hajdari ka nxitur dhunë, duke shkelur nenin 34, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. PDK deklaron se asnjë nga qëndrimet e shprehura nga kandidati i tyre për kryetar ë Komunës së Drenasit, z. Petrit Hajdari, nuk përbën nxitje për dhunë apo provokim për dhunë. Pretendimet e ankuesit janë thjesht një tentativë për të përfituar me çdo kusht në funksion të fushatës zgjedhore, si dhe një keqpërdorim i mundësisë për ankim pranë këtij institucioni të nderuar. Deklarimet e bëra nga kandidati z. Petrit Hajdari përfaqësojnë vlerësimë politike dhe qëndrime të shprehura në kuadër të fushatës zgjedhore, të cilat janë pjesë legitime e diskursit demokratik. Liria e shprehjes, e garantuar nga neni 40 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), mbrojnë veçanërisht të drejtën për të shprehur mendime politike, sidomos gjatë fushatave zgjedhore. Të dyja këto instrumente ndërkombëtare janë të zbatueshme në Kosovë, sipas nenie 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Për më tepër, deklarimet e z. Hajdari përfaqësojnë një mjet të rëndësishëm për nxitjen e debatit publik, i cili është themeli i një procesi zgjedhor të lirë dhe të ndershëm. Përmes komenteve dhe qëndrimeve të tij, qytetarëve të Drenasit u jepet mundësia të informohen, të kuptojnë pozicionet e kandidatëve dhe të zhvillojnë një mendim të pavarur mbi çështjet me rëndësi për komunitetin e tyre. Kufizimi apo ndëshkimi i këtyre deklarimeve do të krijonte një efekt frikësues jo vetëm për z. Hajdari, por për të gjithë kandidatët dhe aktorët politikë, të cilët do të ndiheshin të kufizuar në lirinë e tyre për të shprehur mendime kritike ose të debatojnë për tema sensitive. Përfundimisht, ndëshkimi i deklarimeve të z. Hajdari, siç kërkon ankuesi, jo vetëm që do të përbënte një shkelje të lirisë së tij personale të shprehjes, por edhe një shkelje kolektive të të drejtës së qytetarëve për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në jetën publike, siç garantohet nga Kushtetuta e Kosovës dhe traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë vlerësoj se, pretendimet e subjektit politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenie 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës -së, me të cilën përcaktohet: "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojnë nga bërja e ndonjërsi si*

në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në intervistën kandidatit të PDK-së për kryetar të Drenas, z. Petrit Hajdari sipas vlerësimit të Panelit, nuk përbën nxitje për dhunë apo provokim për dhunë ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, të njëjtat janë vlerësime politike dhe qëndrime të shprehura në kuadër të fushatës zgjedhore dhe me këtë rast paneli nuk ka gjetur se janë shkelur rregullat zgjedhore në dëm të ndonjë subjekti politik.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse".

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.70/2025 datë 29.09.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.